

## **NJOFTIM – ORGANIZATAT NËNGRANTUESE FITUESE TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES NË KUADËR TË THIRRJES PËR PROJEKT-PROPOZIME “PËRFSHIRJA E TË HUAJVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR – QASJA NË TË DREJTAT SOCIALE DHE EKONOMIKE (FOSTER)”**

Këshilli Ballkanik për Refugjatët dhe Migracionin (BRMC) ka zhvilluar procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes për të gjitha organizatat aplikante, të cilat kanë dërguar projekt-propozimet e tyre, në kuadër të thirrjes për projekt-propozime “Përfshirja e të huajve në Ballkanin Perëndimor – Qasja në të Drejtat Sociale dhe Ekonomike (FOSTER)”. Në përfundim të procesit të vlerësimit, organizatat nëngrantuese, të cilat do të zbatojnë projektet e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

1. **Qendra A.L.T.R.I.** – me qëllim forcimin e të drejtave sociale dhe ekonomike të të huajve në Republikën e Shqipërisë duke u bazuar në praktikat më të mira të vendeve evropiane dhe të Ballkanit Perëndimor, duke identifikuar nevojat për përmirësim në kuadrin politik dhe ligjor në Shqipëri, si dhe duke informuar e ndërgjegjësuar të huajt e qytetarët mbi këto të drejta.
2. **Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive (INAC)** – me qëllim përmirësimin e jetës të emigrantëve me leje punësi dhe lufta kundër diskriminimit të tyre për shkak të ngjyrës apo kombësisë, nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të emigrantëve mbi tregun e punës.
3. **Shoqata e Muzikës dhe Artit në Shqipëri (M3A)** – me qëllim të mbrojtë dhe promovojë të drejtat themelore të të huajve brenda Shqipërisë, sipas standardeve të BE-së, me fokus të veçantë në të drejtat kulturore dhe sociale të të huajve në pozita të cënueshme, duke krijuar, ofruar dhe zgjeruar përvojat pozitive të të huajve nëpërmjet krijimit të Trupës së muzikantëve të huaj në Shqipëri.
4. **Rrjeti i Organizatave “Zëri i të Rinjve” (YVNO)** - me qëllim përmirësimin e integritit social të emigrantëve afrikanë në Shqipëri duke rritur ndërgjegjësimin nëpërmjet aktiviteteve kulturore dhe informuese në Shqipëri, duke rritur aksesin e emigrantëve afrikanë në shërbimet sociale, shëndetësore, juridike dhe të punësimit si dhe duke promovuar pranimin kulturor midis komunitetit vendas dhe emigrantëve afrikanë.